

20232684634

АГЕНЦИЈА ЗА СУПЕРВИЗИЈА НА КАПИТАЛНО ФИНАНСИРАНО ПЕНЗИСКО ОСИГУРУВАЊЕ

Bazuar në nenin 101, paragrafi (4) të Ligjit të Sigurimit të Detyrueshëm Pensional të Financuar me Kapital (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 29/2002, 85/2003, 40/2004, 113/2005, 29/2007, 88/2008, 48/2009, 50/2010, 171/2010, 36/2011, 98/2012, 13/2013, 164/2013, 44/2014, 192/2015 30/2016, 21/2018 dhe 245/2018 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 180/2019 dhe 103/2021) dhe nenin 120, paragrafi (4) të Ligjit të Sigurimit Pensional Vullnetar me Financim Kapital (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 07/2008, 124/2010, 17/2011 dhe 13/2013 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 103/2021) Këshilli i ekspertëve i Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve Pensionale të Financuara me Kapital, në seancën e mbajtur më 28.11.2023, miratoi

RR E G U L L O R E PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR PROCEDURËN E ZGJEDHJES SË PERSONAVE JURIDIKË VENDAS, PËR KRYERJE TË SHËRBIMEVE ME LETRA ME VLERË

Neni 1

Në Rregulloren e procedurës së zgjedhjes së personave juridikë vendorë për kryerje të shërbimeve me letra me vlerë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 110/2013, 47/2014, 32/2018 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” 269/2022) neni 7 ndryshohet si vijon:

“Për të marrë pëlqimin e marrëveshjeve të lidhura me subjektet juridike vendase të përzgjedhura, që ofrojnë shërbime me letra me vlerë, shoqëria pensionale dorëzon në Agjencinë e Mbikëqyrjes së Sigurimeve Pensionale me Financim Kapital (në tekstin e mëtejshëm: Agjencia) dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Kërkesë
2. Marrëveshje të lidhur me person juridik vendas që ofron shërbime me letra me vlerë, e cila hyn në fuqi pas dhënies së pëlqimit nga Agjencia, me çmimore për provizione
3. Raport për procedurën e zhvilluar për përzgjedhjen e personave juridikë vendas që kryejnë shërbime me letra me vlerë
4. Fotokopje e ofertave të marra`
5. Fotokopje e dokumentacionit për personin juridik të përzgjedhur që ofron shërbime me letra me vlerë, me të cilin është lidhur marrëveshja, që vërteton përmbushjen e kërkesave të ligjit dhe të kësaj rregulloreje.”

Neni 2

Pas nenit 7 shtohen dy nene të reja: “7-a dhe 7-b”, të cilët thonë:

“Neni 7-a

Kërkesa së bashku me dokumentet e përcaktuara në nenin 7 të kësaj rregulloreje, duhet të dorëzohet në gjuhën maqedonase. Dokumentet nga paragrafi (1) pika 1, 2 dhe 3 të kësaj rregulloreje, dorëzohen në origjinal ose kopje të noterizuara, ndërsa dokumentet nga paragrafi (1), pikat 4 dhe 5 të kësaj rregulloreje dorëzohen në fotokopje.

Kërkesa dhe dokumentet nga neni 7 i kësaj rregulloreje, mund të dorëzohen edhe në formë elektronike, në formë të dokumentit elektronik sipas Ligjit të Dokumenteve Elektronike, Identifikimit Elektronik dhe Shërbimet Konfidenciale. Dokumenti që shoqëria pensionale nuk mund ta dorëzojë si dokument origjinal në formë elektronike, duhet brenda 5 ditësh nga dorëzimi i dokumentacionit, ta dorëzojë në formë origjinale në letër.

Nëse dokumentacioni është i paplotë ose jo i rregullt, Agjencia cakton një afat shtesë në të cilin duhet të dorëzohet dokumentacioni. Nëse shoqëria pensionale nuk e plotëson dokumentacionin ose nuk i eliminon mangësitë brenda afatit të caktuar, konsiderohet se kërkesa është tërhequr dhe Agjencia nxjerr konkluzion, me të cilin ndërpritet procedura e nisur.

Agjencia mund të kërkojë nga shoqëria pensionale të dorëzojë dokumentacion shtesë brenda afateve që do të përcaktojë, për nevojën e dhënies së pëlqimit.

Neni 7-b

Agjencia vendos për kërkesat dhe dokumentet nga neni 7 i kësaj rregulloreje, për një periudhë 60 ditore nga data e pranimit të dokumentacionit të plotë.

Bazuar në vlerësimin e përmbushjes së kushteve të Ligjit të Sigurimit të Detyrueshëm Pensional me Financim Kapital dhe/ose Ligjit të Sigurimit Vullnetar Pensional me Financim Kapital dhe nga kjo rregullore, Këshilli i ekspertëve i Agjencisë, miraton vendim për dhënien e pëlqimit për marrëveshjen e lidhur me personin juridik vendas të përzgjedhur, që kryen shërbime të letrave me vlerë.

Agjencia mund të marrë vendim, me të cilin nuk do të japë pëlqimin e saj për marrëveshjet e lidhura me personat juridikë vendas të përzgjedhur, që kryejnë shërbime me letra me vlerë nëse:

- a) procedura e përzgjedhjes nuk është kryer në përputhje me këtë rregullore, dhe
- b) me provizionet e transaksionit ose dispozitat e tjera të marrëveshjeve të lidhura me personat juridikë vendas të përzgjedhur, që ofrojnë shërbime të letrave me vlerë kërcënohen interesat e anëtarëve dhe anëtarëve të pensionuar të fondeve të pensionit”.

Neni 3

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e nesërme nga dita e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Nr. 01-1721/9
4.12.2023
Shkup

Kryetar
i Këshillit të ekspertëve,
Maksud Ali, d.v.